



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr. 04

Prishtinë, më 28.01.2015, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S - II

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, kryetar, Salih Morina, Bekim Haxhiu, Shpejtim Bulliqi, Ismajl Kurteshi dhe Teuta Haxhiu.

Munguan : Jelena Bontiç, Shukrije Bytyqi dhe Mufera Sinik.

Në mbledhje morën pjesë: përfaqësues të OSBE-së, KDI-së dhe zyrtarët për media të Kuvendit.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi Nait Hasani, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky:

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me 21.01.2015;
3. Miratimi i Planit të punës së Komisionit për vitin 2015;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me 21.01.2015

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur me 21.01.2015 u miratua me plotësimin e diskutimit të Teuta Haxhiut dhe Ismajl Kurteshit.

3. Miratimi i Planit të punës së Komisionit për vitin 2015

Nait Hasani, kryetar tha se propozimet lidhur me Planin e punës së Komisionit për vitin 2015, janë bërë në bazë të programit legjislativ të ministrive përkatëse. Në vazhdim ai i njoftoi anëtarët e Komisionit, se në bashkëpunim me ministrinë që mbulon Komisioni është bërë ndryshimi i disa nga datat për procedim më të shpejtë të projektligjeve nga ana e ministrive përkatëse.

Anëtarët e Komisionit një ditë më parë kanë mbajtur një punëtori të organizuar nga OSBE lidhur me hartimin e planit të punës, ku janë përfshirë propozimet për adresim të çështjeve të fushëveprimtarisë së Komisionit, si dhe u pajtuan për një monitorim sa më të thelluar të zbatimit të ligjeve.

Komisioni njëzëri miratoi Planin e Punës së Komisionit, i cili do të përfshihet në Planin e përgjithshëm të punës së Kuvendit të Kosovës.

Anëtarët e Komisionit u pajtuan që Plani i punës me qëllim të koordinimit të bashkëpunimit t'ju dërgohet ministrive përkatëse.

4. Të ndryshme

Për këtë pikë të rendit të ditës nuk pati diskutues.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani